

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Formulari i njoftimit të fituesit

COBIAL SHPK & GJOKA KONSTRUKSION SHA

Adresa: Njesia Administrative nr.5, Rruga Milto Tutulani, Nd.2, H.19, 1019

TIRANE

Procedura e prokurimit: “Ndertim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4”

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81753-08-02-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1. Fondi limit 2.383.738.991,79 (dy miliarde e treqind e tetedhjetë e tre milione e shtateqind e tridhjetë e tete mije e nenteqind e nentedhjetë e nje) leke pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 576 000 000 lekë. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019, 2020.
2. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit
3. Objekti i kontratës /marrëveshjes kuadër: Ndertim Rruga Kardhiq-Delvine Loti 4

Projekti eshte hartuar nga shoqerite konsulente 47 EK 79 & Iliriada P.K.S shpk & Gjeokonsult & CO shpk. Qellimi i investimi eshte ndertimi dhe perfundimi i plote I aksit rrugor Kardhiq – Delvine, lidhjen me segmentet rrugore te perfunduara dhe me ato qe do te ndertoehen ne vazhdim. Loti 4 Km 0+000.00 - Km 6+150.00. Loti 4 ka nje gjatesi 6150ml. Pikenisja e ketij segmenti eshte fundi i Lotit 1 (qe tashme ka perfunduar ndertimi i tij me projektin e fillestar), dhe respektivisht ne progresivin Pg. 7+124.79. Gjurma e rruges se ketij loti kalon kryesisht ne terren malore kodrinore.

Parametrat per seksionin terthor tip jane sipas kushteve teknike (Kategoria C2) si meposhte:

- 2 korsi kalimi me gjeresi nga 3.5m te asfaltuara
- 2 bankina me gjeresi 1.25 m te asfaltuara
- Bankine e pa asfaltuar pas bordures ne njeran ane (1x0.5) m
- Seksioni total i asfaltuar i rruges ka nje gjeresi 9.50m.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr. 31, date 06.08.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- çmimi më i ulët X
oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Cobial shpk & Gjoka konstruksion sha: NUIS: K02715414M & J91815014U; oferta ekonomike: 2,359,623,275 leke pa TVSH
2. Alb Building shpk; NUIS J69102508C; oferta ekonomike: 2,375,116,614 leke pa TVSH
3. Vellezrit Hysa shpk: s'ka oferte, as dokumentacion
4. Grand Konstruksion shpk: s'ka oferte, as dokumentacion

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Alb Building shpk; NUIS J69102508C;

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk ploteson kriterin 2.3.1 ne lidhje me pune te ngjashme te realizuar ne 3 vitet e fundit pasi operatori ekonomik ka paraqitur nje kontrate te perfunduar me pare, pra qe eshte jashte kesaj perudhe sic parashikohet ne dokumentat e tenderit.

Nuk ploteson kriterin 2.3.6 ne lidhje me pikat e licenses qe duhet te disponoje operatori ekonomik

- per kategorie NP-12 kerkohet kualifikimi F ndersa operatori ekonomik Alb-Building shpk disponon kualifikimin E
- per kategorie NS-18 kerkohet kualifikimi D ndersa operatori ekonomik Alb-Building shpk disponon kualifikimin C

Nuk ploteson kriterin 2.3.7 ne lidhje me mjetet dhe paisjet qe duhet te kete ne dispozicion dhe konkretisht *Impiant asfalti ne distance jo me lart se 70 km, në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, Copë 1*, rezulton qe nga operatori ekonomik ka paraqitur nje fabrike asfalti qe ndodhet ne afersi te Rinasit, pra ne distance me te madhe se 70 km, kjo ne kundërshtim me kriterin e dhene me siper.

Dy operatorët e tjere emri i te cileve shfaqet ne sistem nuk kane paraqitur asnje dokumnetacion, per pjesemarrje ne kete procedure prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimi i perkohshem i operatoreve ekonomik **Cobial shpk & Gjoka konstruksion sha**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2,359,623,275 (*dymiliarde e treqind e pesedhjetë e nente milione e gjashtëqind e njezet e tre mijë e dyqind e shtatedhjetë e pese*) leke, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, Adresa; Rruga "Sami Frashëri nr.33", Tiranë, Tel/Fax +355 4 2234789 / +355 4 2223600, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.09.2018.

Ankesa: Nuk ka